



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Data \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2025

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: "Blerje dhe instalimi i 3 pemëve "Smarflower" dhe ndertim stacioni komercial të EV për makinat elektrike".**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09310000-5  
ELEKTRICITET 0933000-8 PANELE DIELLORE**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 11 250 000 (njëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë)  
lekë pa tvsh.**

**Argumentimi i fondit limit:** Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”, KLLFLST për llogaritjen e cmimit është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre në VKM nr.625 datë 15.07.2015 (ndryshuar me VKM-në nr.631 datë 26.10.2018) me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. (Dokumentuar me relacionin shpjegues të KLLFLST nr.296/2 datë 16.01.2025.

Arsyeja e përdorimit të procedurës së prokurimit: “E hapur” është sepse fondi limit është mbi kufirin e ulët monetar në sektorin klasik bazuar në Ligjin nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar nenin 42; në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 11 pika 1 dhe neni 47, 74, 77, si dhe në VKM nr. 291 datë 15.5.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, kreu II pika 2/a.

Në bazë të nenit 21 pika 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenit 2 pika c dhe nenit 78 pika 2 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti/enti Kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar neni 83 pika 1 si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 30 pika 1. Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 26 i VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Këto kriterë janë vendosur për të vërtetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte. Gjithashtu këto kriterë janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1.Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 7 dhe 8.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 14 pika 2 dhe 77 pika 1/a dhe 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; nenin 39 pika 6/b dhe nenin 88 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesëmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik.

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1.**Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 pika 3 e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe nenin 43 pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

---

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 43 pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës konkretisht, Ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë nga OE pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojë raportet nëpërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit 29 të ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” i ndryshuar: *“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë të Financave, në zbatim të këtij ligji”.*

---

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 në zbatim të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

*Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetedeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43 pika 6 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Vendosija e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

---

### 2.3 Kapaciteti teknik:

Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi kontrata të mëparshme të ngjashme me objektin e procedurës së prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit ku vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës perkatesisht: **4 500 000 leke pa TVSH.**

**2.3.1** Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e realizuara.

Per kontratat e realizuar si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese: Kontraten e bashkimit te operateve te deklaruar ne fazen e tenderimit.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Duke patur në konsideratë vlerën e objektit të prokurimit: **"Blerje dhe instalimi i 3 pemëve "Smarflower" dhe ndertim stacioni komercial të EV për makinat elektrike "** pika 3 e nenit 77 e Ligjit nr.162/2020 "Per prokurimin publik" i ndryshuar; neni 43 pika 1 dhe 2/c të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar..”*, si dhe mbi bazën e nenit 29 të ligjit nr. 8438 date 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës”*, si pika 1 dhe 2/c, në zbatim të nenit 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, VKM-së Nr. 922

datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe nenit 41 gërma "c" të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar. Kriteri 2.3.1 është vendosur referuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 47 te VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar si dhe bazuar ne nenin 77 pika 4 te Ligjit nr.162 date 23.12.2020 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë, dhe mjedisit.

Për këtë duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- a) ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente (e vlefshme).
- b) ISO 45001:2018 (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë) ose ekuivalente (e vlefshme).

**Çertifikatat të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.**

**Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë.**

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas nenit 79 pika 1 e ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar ku citohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë" si dhe ne zbatim të nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit".

Autoriteti Kontraktor gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikata e kërkuara janë në përputhje me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

ISO 9001:2015 është kërkuar me qëllim vërtetimin e efektivitetit dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së operatorit ekonomik, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove, duke bërë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 45001:2018 është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgatitjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor, ku veprimtaria e ushtruar nga ana tije (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”* e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP.1 A	<ul style="list-style-type: none"> <li>Punime gërmimi në tokë</li> </ul>
2	NP.10 A	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike</li> </ul>
3	NP.11 A	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërtimi për N/stacionet, kabinetat e transformatoreve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarja e energjisë</li> </ul>

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39 pika 6/a të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga organet kompetente shtetërore”,* si dhe në klasifikimin e niveleve (gërmave) për punimet sipas natyrave respektive, të parashikuara në VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar neni 8 përcakton: *“Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, Autoriteti Kontraktor argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit*

të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1 Punime gjurmimi në tokë	Punime gjurmimi në tokë	<b>1. Gjurmim dhe Zinxhire per dekor</b>	Niveli A	leke pa tvsh
<b>NP-10</b> Ndertimi i impianteve per prodhimin e energjise elektrike	Ndertimi i impianteve per prodhimin e energjise elektrike	<b>Karikues Kabine metalike</b>	Niveli A	leke pa tvsh
<b>NP-11A</b> •Ndertimi per N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesem dhe shperndarja e energjiseet, kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesem dhe shperndarja e energjise	•Ndertimi per N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesem dhe shperndarja e energjise	<b>Kabell ne toke kuader kolaudimi</b>	Niveli A	54

Klasifikimi sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar.

### **Kategoria NP-1 A (Punime gërmimi në tokë)**

Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise të punimeve të cilat përfshijnë gërmimet për themelet e godines së re, gërmim për kanalizimet KUZ të shkolles, gërmime dhe sistemime të ndryshme të shesheve për ndërtimin e terreneve sportive, operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

### **N.P.10 (Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike)**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, ose që janë të nevojshme për prodhimin e energjisë elektrike, të kompletuara me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit, përfshirë edhe të gjitha impiantet mekanike, elektromekanike elektrike, telefonike, elektronike, të nevojshëm për funksionim, sigurim dhe asistencë. Përfshin hidrocentralet dhe termocentralet.

### **N.P.11 Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri të përdoruesit të energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloji të tensionit, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

**2.3.3.a.** Referuar preventivit, grafikut, specifikimeve teknike si dhe punimeve ndërtimore, Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik

#### **Për të cilin duhet të paraqiten:**

- Kontratë punë e vlefshme
- Diploma
- CV
- Licence

Drejtuessit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit. Për këtë arsye të paraqitet deklarate perkatëse nga Administratori i shoqërisë.



Operatorët ekonomik duhet të caktojë me anë të një dekaratë Drejtuesin Teknik të punimeve i cili duhet të jetë i përfshirë në license e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

*\* Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesin e kerkuar si me siper, emer/mbiemer, numrin dhe daten e certifikates, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar.

**Argumentimi:** Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar neni 77 pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39 pika 6 gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafi i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

**2.3.3.b.** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesat e subjektit, punonjesit specialistë të kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (nje) Punonjës teknik ndërtimi
- 1 (nje) Karpentier
- 1(nje) Elektricist

Për punonjësit me profesionet si më sipër, ne menyre qe Autoriteti Kontraktor te kete mundesine e verifikimit, Operatoret Ekonomike duhet te plotesojne dhe ngarkojne tabelen e meposhtme me te dhenat e sakta qe i perkojne diplomes/certifikates se formimit profesional nga Institucione

Private apo Shtetërore, te cilat regjistrohen ne bazen e te dhenave te AKPA-se prane Ministrise se Financave (Institucioni pergjegjes per formimin profesional).

Nr.	Emër i Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr amzes/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
etj					

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës;
- Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (certifikatë/deshmi), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara /akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqiperise.”

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor*

**Argumentimi:** Kërkesat e pikes **2.3.3.b** janë bazuar në nenin 77 pika 4 e Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 39 pika 6/c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.SH” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**2.3.3.c** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se ka të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR. **minimalisht** si më poshtë:

- 1 (nje) Manovrator
- 2 (dy) Shofer

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional) që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i

përdorimit të tyre” miratuar me Urdherin nr. 200, datë 16.5.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

*\* Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e kërkuar si me sipër, emer/mbiemer, numrin dhe datën e dëshmisë së aftësisë profesionale.*

***\*(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).***

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26 pika 6, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 e Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 39 pika 6/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punwtore, te nevojshem për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

**2.3.3.d** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **1 (nje) punëtor të thjeshtë**, për të cilin të paraqitet kontrata e punës si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimalisht për muajin e fundit.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punonjësit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar**, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë llogaritur nepermjet analizave teknike nga anëtarët e Njesise se Prokurimit me profil inxhinier ndertimi, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht Vendimit Nr .216 Datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Numri i punëtorëve është si rezultat i analizës teknike që kanë antarët e Njesise se Prokurimit me profil inxhinier ndertimi, kane kryer llogarite perkatese.

**2.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinc	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator	1 cope	Pronësi ose me qera
Elektrokompresor	1 copë	Pronësi ose me qera
Minibetonier	1 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator thellesie	1 cope	Pronësi ose me qera
Kokore	10 copë	Pronësi ose me qera
Jelek	10 copë	Pronësi ose me qera

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- b) Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit te vlefshme), duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerave e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, si kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese.
- d) Autoriteti Kontraktor gezon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerinë e këtyre mjeteve si gjatë vleresimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit dhe Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike pikat e kriterit 2.3.5 duhet të plotesohen nga secili anëtar i bashkimit, **në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje**).

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 39 pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

**2.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Katalogun e pajisjeve të mëposhtme, Certifikata ISO Prodhuesi/Distributori, Kontratë furnizimi ose marreveshje bashkepunimi me Prodhuesin/Distributorin për:

- Smart flower, instalacion fotovoltaik për prodhimin dhe ruajtjen e energjisë
- Bateri për ruajtjen e energjisë
- Karikues me porta karikimi

Ky kriter është vendosur për shkak të specifikave që ka kjo paisje e cila importohet nga vendet e tjera prodhuese. Për këtë arsye, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin katalogun e pajisjeve, i cili duhet të përmbajë informacion të detajuar për karakteristikat dhe specifikimet teknike të pajisjes, në mënyrë që të mund të vlerësohet përputhshmëria e saj me kërkesat teknike dhe cilësore të objektit të procedurës së prokurimit.

**Argumentim:** Ky kriter është në përputhje me nenin 77 e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 40 pika 6 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Paraqitja e katalogeve objekt prokurimi është kërkuar me qëllim sigurimin e pajisjeve të kërkuara të jenë në përputhje me kërkesat teknike dhe cilësore të specifikuar si dhe sigurimin e përputhshmërisë në standartet e sigurisë dhe edikacionit. Ky kriter është mjaft i rëndësishëm për kontrollin e cilësive, garantimin e

perputhshmerise dhe sigurimin e transparences gjate prokurimit.

Kerkimi i kontratës se furnizimit ose marreveshje bashkepunimi me Prodhuesin/Distributorin eshte vendosur si kriter me qellim sigurimin qe operatori ekonomik ka nje lidhje te drejteperdrejte dhe te besueshme me furnizuesin e pajisjeve apo materialeve duke garantuar qe pajisjet jane te kualitetit te duhur dhe te disponueshme ne kohen e nevojshme per perfundimin e punimeve.

**2.6** Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë-garancie për periudhën **3 vjeçare** të garancisë së pajisjeve që kërkohen të prokurohen e cila fillon nga data e dorëzimit të artikujve objekt prokurimi.

Gjate kesaj periudhe ofertuesi do te siguroje riparimin, mirembajtjen dhe sherbimin pa pagese te defekteve per shkak te prodhimit dhe montimit.

**Argumentimi:** Neni 36 i Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë dhe që i vlerëson mallrat.

**2.6 Sqarim per ofertuesit:** Ne respektim dhe zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, neni 26 neni 39, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 26 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar,.

Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues të renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për pikat a, b, d, dh, e, h, I, j të pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si edhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26 pika 1 e VKM-së, nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

\*\*\*

## **Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, bazohen në parashikimet e nenit 4, nenit 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenit 39 pika 2, të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike të këtij objekti prokurimi janë përcaktuar nga Komisioni i posacëm: **KLLFLST**, sipas materialit bashkëlidhur ne SPE.

**SPECIFIKIMET TEKNIKE TË KËTIJ OBJEKTI PROKURIMI JANË PËRCAKTUAR NGA KLLFLST NË PROJEKT DHE SHPREHIN QARTE KERKESAT E AUTORITETIT KONTRAKTOR PËR CILËSINË E KRYERJES SË PUNIMEVE SIPAS MATERIALIT BASHKËLIDHUR NE SPE.**

\*\*\*

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor **Nr. 01 datë 17.01.2025**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **“Blerje dhe instalimi i 3 pemëve "Smarflower" dhe ndertim stacioni komercial të EV për makinat elektrike ”**, me fond limit prej: **11 250 000 (njëmbëdhjetë milion e dyqindë e pesëdhjetëmijë) lekë pa tvsh.**

## **Lloji i procedures: E hapur-Mallra**

Kriteret do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

\*\*\*

**Argumentim:** Anëtarët pranuan procesverbalin, preventivin dhe dokumentacionin teknik të hartuara nga Komisioni i posacëm: **KLLFLST (Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike)** i ngritur me Urdher të titullarit të Autoritetit Kontraktor **nr. 296 prot datë 16.01.2025.**

Preventivi është hartuar nga specialistet e fushës konkretisht nga KLLFLST dhe procesverbalin e komisionit nr.296/1 prot datë 16.01.2025 dhe shprehin qarte kërkesat e Autoritetit Kontraktor për cilësinë e e kryerjes së punimeve.

Preventivi i hartuara nga KLLFLST si më poshtë për objektin: "Blerje dhe instalimi i 3 pemëve "Smarflower" dhe ndertim stacioni komercial të EV për makinat elektrike",

### PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Nr .	Nr. An	EMERTIMI I PUNIMEVE	Njesi a	Sasia
		<b>A. Smart-Flower</b>		
	<b>A</b>	<b>I. Punime per vendosjen e struktures mbajtese te Smart Flower</b>		
1	2.15a	Germim e mbushje dheu me krah per kanale kategori IV, h=1.5m	m <sup>3</sup>	4.5
2	3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20 per fiksimin e struktures	m <sup>3</sup>	2.8
3	3.766	Ankera ø=18cm, h=1m , per fiksimin e struktures dhe bullona	ton	0.032
		<b>SHUMA 1</b>		
	<b>A</b>	<b>2.PUNIME ELEKTRIKE PER FURNIZIMIN ME ENERGJI</b>		
1	3.89/a	Germim dheu hapje kanali per kablllo	m <sup>3</sup>	11.0
2	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m <sup>3</sup>	11.0
3	2.261/a	Nenshtrese rere	m <sup>3</sup>	4.0
4	An.16	F.V. Kuader komandimi komplet rrugor me fotoelemet	cope	3.0
5	4.47	FV. Kabell në tokë kabëll fuqie 0.6/1kV, XLPE, AL-4x120mm <sup>2</sup>	ml	32.0
		<b>SHUMA 2</b>		
	<b>A</b>	<b>3.PUNIME PER STOLAT</b>		
1	3.89/a	Germim dheu	m <sup>3</sup>	10.0
2	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m <sup>3</sup>	10.0
3	2.261/a	Nenshtrese rere	m <sup>3</sup>	5.0
4	3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20 per fiksimin e struktures	m <sup>3</sup>	2.2
5	An	Stola rrethor dekorativ	cope	3.0
6	3.932/2	F.v. Tabela katrore e madhe me diagonal vertikal	cope	1.0
		<b>SHUMA 3</b>		
	<b>A</b>	<b>4.PUNIME PER MONTIMIN E SMART FLOWER</b>		
1	Treg	F.V Smart flower , instalacion fotovoltaiik per prodhimin dhe ruajtjen e energjise	cope	3.0



2	Treg	Bateri per ruajtjen e energjise 41-59V, 200 Mph	cope	3.0
<b>SHUMA 4</b>				
<b>Shuma totale A per vendosjen e 3 Smart flower</b>				
<b>Shuma totale A me TVSH</b>				
<b>Nr .</b>	<b>Nr. An</b>	<b>EMERTIMI I PUNIMEVE</b>	<b>Njesi a</b>	<b>Sasia</b>
<b>B .Karikuesi Elektrik</b>				
<b>1. Punime per vendosjen e struktures mbajtese te karikuesit elektrik</b>				
1	2.15a	Germim e mbushje dheu me krah per kanale kategori IV, h=1.5m	m <sup>3</sup>	1.0
2	3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20 per fiksimin e struktures	m <sup>3</sup>	1.0
3	3.766	Ankera $\phi=18\text{cm}$ , h=1m , per fiksimin e struktures dhe bullona	ton	0.050
<b>SHUMA 1</b>				
<b>B 2PUNIME ELEKTRIKE</b>				
1	3.89/a	Germim dheu hapje kanal per kablo	m <sup>3</sup>	5.0
2	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m <sup>3</sup>	5.0
3	2.261/a	Nenshtrese rere	m <sup>3</sup>	1.1
4	An.16	F.V. Kuader komandimi komplet rrugor me fotoelemet	cope	1.0
5	4.47	FV. Kabell në tokë kabëll fuqie 0.6/1kV, XLPE, AL-4x120mm <sup>2</sup>	ml	20.1
<b>SHUMA 2</b>				
<b>B 3.PUNIME PER MONTIMIN E KARIKUESIT ELEKTRIK</b>				
1	Treg	F.v Karikues EVPro3F 32A 22kË+kabell+RFID+RCD Asi 30mA IP55Ëal porta karikimi	cope	2.0
2	Treg	F.V Kabine metalike per vendosjen e 2 kokave te karikimit	cope	1.0
3	Treg	F.V Makineri pagese me vetsherbim	cope	1.0

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do ti paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për t'u firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

## NJËSIA E PROKURIMIT